



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:294447  
Datë: 23.10.2024  
Numri i dokumentit: 06337526

**CA.nr.3966/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Lumni Sallauka - kryetar i kolegjit, Adnan Konushevcu dhe Dardan Kadolli - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit H.S nga M..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Sh.A dhe L.A, të dy avokat në M..., kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria e Arsimit, me objekt kontesti, kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2059/2023, të datës 21.02.2024, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë **14.10.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2059/2023, i datës 21.02.2024, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.2059/2023, të datës 21.02.2024, ka vendosur si në vijim *”I.APROVOHET kërkesëpadia e paditësit H.S, nga M..., NË TËRËSI SI E BAZUAR. II.DETYROHET e paditura Komuna e Mitrovicës Jugore - Drejtoria e Arsimit, me seli në Mitrovicë, që paditësit në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit, për 68 ditë gjatë vajtje-ardhjes në punë, në ShFMU “XH.J” në B..., Komuna e Mitrovicës, për periudhën kohore nga data 11.11.2021, e deri me datë 22.11.2022, t’ia paguajë shumën prej 42.40 Euro, dhe për 101 ditë gjatë vajtje-ardhjes në punë, në ShFMU “T...” në S..., Komuna e Mitrovicës, për periudhën kohore nga data 11.11.2021, e deri me datë 22.11.2022, t’ia paguajë shumën prej 95.20 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë, si dhe*

*shpenzimet e procedurës në shumë prej 98.00 Euro, në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.”*

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshojë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar.

Paditësi nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e të paditurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është **e pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shujtës ditore dhe udhëtimit për periudhën 11.11.2021-22.11.2022, kundër të paditurës, me arsyet sikurse në padi, duke kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve procedurale.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave, si dhe të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.2059/2023, të datës 21.02.2024, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se nuk rezulton të jetë kontestuese fakti, se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht mësimdhënës në ShFMU “Xh.J”, në B..., Komuna e Mitrovicës, dhe në ShFMU “T...”, në S..., Komuna e Mitrovicës, fakt ky i vërtetuar edhe përmes kontratës me nr.41/22, të datës 07.06.2022. Po ashtu nuk rezulton të jetë kontestuese as fakti, se paditësi për periudhën nga data 11.11.2021, e deri me datë 22.11.2022, ka qenë i pranishëm në punë, për 68 ditë në ShFMU “Xh.J”, në B..., dhe për 101 ditë në ShFMU “T...” në S..., fakt ky i vërtetuar edhe nga Vërtetimi nr.51/23, i datës 09.11.2023, dhe Vërtetimi nr.153/23, i datës 30.10.2023, të lëshuara nga shkollat e lartcekura. Nga certifikata e vendbanimit nr.B10506868, të lëshuar me datë 06.12.2023, nga Komuna e Mitrovicës, vërtetohet se paditësi është me vendbanim dhe vendqëndrim në Mitrovicë, në Rr.“N.D” nr.4. Lidhur me lartësinë e kërkesëpadisë gjykata vendosi duke u bazuar në Vërtetimin e datës 08.12.2023, të lëshuar nga N.T. “B.T”, në M..., nga dëshmohet se relacioni vajtje-ardhje nga Mitrovica për në fshatin Bare është 2.00 Euro, për 68 ditë punë, në total 136.00 Euro, dhe meqenëse se paditësit i takon 70% e shumës së biletës, atëherë shuma e kompensimit është 95.20 Euro, ndërsa nga vërtetimi i datës 08.12.2023, të lëshuar nga N.T. “B.T”, në M..., dëshmohet se relacioni vajtje-ardhje nga Mitrovica për në fshatin Stantërg është 0.60 Euro, për 101 ditë punë, në total 60.60 Euro, dhe meqenëse se paditësit i takon 70% e shumës së biletës, atëherë shuma e kompensimit është 42.42 Euro, e në total shuma prej 137.62 Euro.Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragraf 5 dhe 7 të Kontratës Kolektive të

Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017. Vendimin mbi kamatën e ka mbështetur në nenin 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, ndërsa vendimin për shpenzimet e ka bazuar në nenin 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (*më gjerësisht si në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar*).

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së, ndërsa nuk qëndrojnë edhe pretendimet tjera të palës ankuese të cekura në ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Si rrjedhojë, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës, udhëtimi i paditësit dhe prezenca në punë tek e paditura, përkatësisht në institucionin ku punon.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive".

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'iu paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit në punë dhe me të drejtë është bazuar në nenin 35 par. 5 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e nënshkruar me datë 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), e cila ka qenë e zbatueshme edhe në kohën kur është paraqit padia nga ana e paditëses, duke i përmbush kështu kushtet për kompensimin e ushqimit në bazë të nenit 35 par.7 të KKAK-së.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës së paditur se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për kompensimin për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë si dhe të udhëtimit ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale. Sipas

vlerësimi të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale në pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë se paditësit për faktin se ajo pasi ka konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe ka vërtetuar faktet të cilat ishin vendimtare për çështjen kontestuese, (ndërsa ditët e prezencës në punë dhe për shpenzimet e udhëtimit janë provuar përmes vërtetimeve të cilat gjenden edhe në shkresat e lëndës) ka zbatuar drejtë dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, duke iu referuar nenit 35 par.7 në të cilin parashihet *"Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjate punës për ditët e pranisë ne pune. Vlera e kompensimit te ushqimit për një dite te pranisë ne pune është 2 euro, për te punësuarit qe kane marrëdhënie primare të punës në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka te rregulluar ushqimin e te punësuarve përmes restorantit apo kuzhinës apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim për ta bere kompensimin"*. Po ashtu gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka kompensuar edhe shpenzimet e udhëtimit ne pajtim me nenin 35 par.5 ku përcaktohet se: *"Punonjësit arsimore që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban"*. Gjykata e Apelit shton se edhe Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës e datës 22.01.2021, e lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) e Republikës së Kosovës, në nenin 35 par.5 dhe 7 të saj ka rregulluar në mënyrë të njëjtë të drejtën e punëtorëve të arsimit në kompensimin e ushqimit gjatë punës dhe udhëtimit. Andaj, bazuar edhe në këtë kontratë, kjo gjykatë vlerëson se paditësit i ka takuar kompensimi i vendosur sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Njëherit gjykata i ka vlerësuar të papranueshme pretendimet ankimore të paditurës, se nuk është paraparë me Ligjin e Punës apo se nuk është nënshkruese e kontratës kolektive, ngase i njëjti është paraparë me dispozitat e KKAK-së, nënshkruese e të cilës është edhe MASHT-i, andaj e paditura nuk lirohet nga obligimi për pagesën e shumave të gjykuara, sepse kontratat e nënshkruara në mes palëve kanë bazë ligjore në LMD-në, dispozitat përkatës të këtij ligji neni 7 që e rregullojnë materien e çështjes së kontratës, si dhe konform nenit 8 par.1 të LMD-së, ku shprehimisht thuhet *"Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit"*.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe pretendimin ankimor të paditurës për çështjen e detyrimit të saj për të kompensuar paditësen, mirëpo ka ardhur në përfundim se një pretendim i tillë është i pabazuar, për faktin se e paditura qëndron në detyrimin ndaj paditëses edhe pse nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit/Kontrata nr.24. e datës 18.04.2017, pasi që në nenin 2 të Kontratës është përcaktuar se kjo kontratë është e zbatueshme edhe për komunat apo DKA-të. Gjithashtu pretendimi i të paditurës për skadimin e kontratës kolektive të vitit 2017, nuk qëndron pasi që edhe Kontrata Kolektive e Arsimit të Kosovës e datës 22.01.2021, e lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) e Republikës së Kosovës, në nenin 35 par.5 dhe 7 të saj ka rregulluar në mënyrë të njëjtë të drejtën e punëtorëve të arsimit në kompensimin e ushqimit gjatë punës dhe udhëtimit. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se paditësit i ka takuar kompensimi i vendosur sikurse në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Andaj, gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'i paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë dhe udhëtimin, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës (MASH), të datës 18.04.2017 (e zbatueshme deri me datën 21.01.2021) dhe datës 22.01.2021 dhe se të njëjtat janë në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 398 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”* Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, drejtë është aplikuar e drejta materiale, lartësia e kamatës është në pajtim me nenin 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, Gjykata e Apelit ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**CA.nr.3966/2024, datë 14.10.2024**

**Kryetar i kolegjit,**  
**Lumni Sallauka**